



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 662/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin Milorad Šarković, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Milorad Šarković, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Klinë, me shenjen ZL.Anr.662/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.662/2017 me datën 09.11.2017, nga Milorad Šarković, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, ku thekson se dyshon në manipulim gjatë numërimit të votave, pasi që sipas tij është e pamundur që përmes postës të vijnë aq shumë vota për kandidatin Bojan Saicić . Sipas parashtruesit të ankesës Lista Serbe ka më shumë vota në vendvotimet lokale në Klinë dhe atë 148 vota plus 30 me kusht, ku ne ate vendvotim kandidati Bojan Saicić i ka 17 vota. Për këtë arsye parashtruesi i apelit kërkon që ti lejohet qasja në fletëvotimet që kanë ardhur me post nga Serbia.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel të apellesit gjeti se me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar për ti vërtetuar pretendimet e tij lidhur me parregullsitë e pretenduara. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë

jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

ZL.Anr.662/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*